

UDHËZIM
Nr. 481, datë 27.6.2019

PËR PROCEDURAT E PUNËSIMIT PËR PROFESIONET E SHKENCAVE
MJEKËSORE TEKNIKE NË INSTITUCIONET SHËNDETËSORE PUBLIKE NË
REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

(ndryshuar me udhëzimin nr. 296, datë 18.6.2021)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, bazuar në ligjin nr. 27/2019 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10107, datë 30.3.2009 “Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, si dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 419, datë 4.7.2018 “Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor”,

UDHËZOJ

KREU 1
TË PËRGJITHSHME

1. Ky udhëzim rregullon procedurat për punësimin e profesionistëve të shkencave mjekësore teknike në institucionet shëndetësore publike.

2. Shpallja e vendeve të lira të punës, konkurrimi, renditja e kandidatëve, si dhe emërimi në një vend të lirë pune realizohen nëpërmjet portalit “Infermier për Shqipërinë”.

3. Portali “Infermier për Shqipërinë” është një mekanizëm i ngritur për punësimin e teknikëve të shkencave mjekësore në bazë meritokracie duke siguruar transparencë, efikasitet dhe shanse të barabarta.

4. Drejtoria Qendrore e Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor (në vazhdim “DQOSHKSH”) është institucioni përgjegjës për procedurat e konkurrimit dhe të pranimit të profesionistëve të shkencave mjekësore në një vend të lirë pune në institucionet shëndetësore publike, ndërsa drejtoritë rajonale të shërbimeve të kujdesit shëndetësor (në vazhdim “DROSHKSH”) organizojnë procedurat sipas këtij udhëzimi.

5. Thirrja për konkurrim shpallet sipas profileve për profesionistët e shkencave mjekësore teknike, mbi bazë të Njesisë Vendore të Kujdesit Shëndetësor (në vijim “NJVKSH”) duke përfshirë dhe spitalet respektive.

6. Procesi i konkurrimit për profesionistët e shkencave mjekësore teknike, zhvillohet për:

a) të gjithë kandidatët që plotësojnë kriteret e përcaktuara në kuadrin ligjor në fuqi për ushtrimin e profesionit;

b) kandidatët që kanë marrë pjesë në testimin “Infermierë për Shqipërinë” të thirrjes paraardhëse dhe që dëshirojnë të përmirësojnë rezultatin e tyre.

7. DROSHKSH-ja ka detyrimin të raportojë në DQOSHKSH lëvizjet paralele dhe vendet e lira të punës në 2 (dy) ditët e para të çdo muaji.

8. DQOSHKSH-ja ka detyrimin të shpallë në portalin “Infermier për Shqipërinë” përgjatë gjithë vitit, vendet e lira të punës për çdo institucion shëndetësor publik, si dhe listën e punësimeve të kryera në muajin paraardhës brenda 5 (pesë) ditëve të para të çdo muaji.

9. Shpallja në portalin “Infermierë për Shqipërinë” përmban këto të dhëna:

- a) fushën kryesore mbi të cilën do të bazohet konkurrimi, si dhe dokumentet që do të vlerësohen në konkurrim;
- b) fazat në të cilën do të kalojë konkurrimi, vlerësimi i dosjes dhe testimi i informatizuar;
- c) dokumentet që duhet të dorëzohen dhe mënyrën e dorëzimit të tyre;
- d) afatin e dorëzimit të përcaktuar me datë të saktë kalendarike;
- e) datën e daljes së rezultateve për fazën e vlerësimit paraparak të kandidatëve;
- f) mënyrën e vlerësimit të kandidatëve në fazën e vlerësimit të dosjes, si dhe në fazën e testimit të informatizuar;
- g) mënyrën e njoftimit dhe komunikimit me kandidatët.

10. Regjistrimi i kandidatëve bëhet vetëm nëpërmjet internetit në portalin “Infermierë për Shqipërinë”. Të interesuarit do të kenë si afat për kryerjen e aplikimit të paktën dy javë kalendarike nga data e shpalljes.

11. Dokumentacioni duhet të dërgohet brenda afatit të caktuar në ditë kalendarike nga dita e parë e shpalljes në portalin “Infermierë për Shqipërinë”, si dhe një kopje me postë ose dorazi të protokollohet pranë DROSHKSH-së përkatëse, sipas përcaktimit në shpalljen për konkurrim.

KREU 2 KOMISIONI I VLERËSIMIT

1. DQOSHKSH-ja krijon komisionet e vlerësimit në nivel rajonal (sipas ndarjes të katër drejtorive rajonale të operatorit të shërbimeve të kujdesit shëndetësor).

2. Komisioni i Vlerësimit përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë, si më poshtë vijon:

- a) 2 (dy) anëtar nga Drejtoria Rajonale e Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor, kryetar i komisionit është drejtori i DROSHKSH-së;
- b) 1 (një) anëtar nga Drejtoria Qendrore e Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor;
- c) (dy) anëtarë nga institucionet shëndetësore, të paktën njëri të jetë në profilet e shkencave teknike mjekësore.

3. Sektori i Menaxhimit të Burimeve Njerëzore në DROSHKSH, kryen rolin e sekretarit teknik për mbajtjen e të dhënave dhe të dokumentacionit të aplikantëve.

4. Komisioni i Vlerësimit kryen detyrat si më poshtë:

- a) administron dosjet e aplikantëve që kanë aplikuar në portalin “Infermier për Shqipërinë”;
- b) vlerëson dokumentacionin e dosjes së çdo kandidati, sipas kritereve të vlerësimit të përcaktuara në këtë udhëzim;
- c) evidenton kandidatët që u mbarten pikët, si dhe rastet kur kandidatët sjellin dokumente shtesë në dosjen e tyre;
- d) shqyrton ankesat e kandidatëve për vlerësimin e marrë;
- e) përgatit listat e kandidatëve që do të marrin pjesë në testimin e informatizuar;
- f) bën renditjen e kandidatëve sipas pikëve të marra në secilën fazë të vlerësimit dhe ato në total në përfundim të vlerësimit;
- g) dërgon elektronikisht dhe zyrtarisht në DQOSHKSH dhe në MSHMS listën me pikët për çdo kandidat;

b) Komisioni i Vlerësimit monitoron procesin e përzgjedhjes së vendeve të lira të punës, më specifikisht: njoftimin, ofrimin dhe përzgjedhjen e vendeve vakante për profesionistët e shkencave mjekësore teknike.

5. Anëtarët e Komisionit të Vlerësimit duhet të verifikojnë dhe të shmangin konfliktin e interesit me kandidatët.

KREU 3

PROCEDURA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Vlerësimi i kandidatëve përfshin:

a) *Vlerësimin e dosjes së kandidatëve që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të përvojës e të trajnimeve, të lidhura me fushën, deri në 30 pikë. Brenda numrit total prej 30 pikësh shtohet bonus si më poshtë:*

- *studenteve të ekselencës 10 pikë,*
- *profesionistëve të shkencave mjekësore teknike, që kanë punuar për diagnostikimin dhe trajtimin e pacientëve të prekur nga COVID-19, në spitalet kovid 1, 2, 3 dhe 4 (të vërtetuar me shkrim nga DROSHKSH Tiranë) për një periudhë mbi tre muaj, 5 pikë;*

b) vlerësimi i testit të informatizuar, deri në 70 pikë;

3/1 KONKURRIMI ME DOSJE

1. Në fazën e parë, kandidatët e interesuar regjistrohen në portalin “Infermierë për Shqipërinë”.
2. Jetëshkrimi standard dhe dokumentet e tjera të parashikuara në shpallje, dërgohen nëpërmjet internetit në portalin “Infermierë për Shqipërinë”, ku gjenden edhe udhëzimet përkatëse, si dhe një kopje me postë ose dorazi protokollohet pranë DROSHKSH-së përkatëse, sipas përcaktimit në shpalljen për konkurrim.
3. Dokumentet e aplikimit për profesionistët e shkencave mjekësore teknike që duhet të hidhen në portal në momentin e aplikimit janë:
 - a) *Curriculum Vitae* sipas modelit të përcaktuar në shtojcën nr. 1, bashkëlidhur këtij udhëzimi;
 - b) fotokopje e diplomave dhe lista e notave për çdo diplomë (e detyrueshme);
 - c) fotokopje e lejes së ushtrimit të profesionit (e detyrueshme);
 - d) fotokopje e librezës së punës (nëse ka);
 - gj) vërtetim për gjendjen gjyqësore (e detyrueshme në momentin e fillimit të detyrës);
 - e) raporti mjeko-ligjor i tre muajve të fundit (i detyrueshëm në momentin e fillimit të detyrës);
 - f) Deklaratë nga kandidati për autorizimin e institucionit shëndetësor që të shqyrtojë vërtetësinë e dokumenteve të paraqitura (sipas shtojcës nr. 2).
4. Kandidati, dosja e të cilit nuk përmban dokumentet e detyrueshme si më sipër, skualifikohet.
5. Skema e vlerësimit të dosjes së kandidatëve, përcaktohet në shtojcën nr. 3, bashkëlidhur këtij udhëzimi.
6. Kandidatët kanë të drejtë, që në një thirrje për aplikim, të konkurrojnë vetëm për një rajon, brenda të cilit do të mund të për zgjedhin, deri në tre NJVKSH.
7. Kandidati i cili ka qenë pjesëmarrës në portalin e mëparshëm dhe ka dokumentacion shtesë, i depoziton ato pranë Komisionit të Vlerësimit kur hapet portali i radhës, Komisioni i Vlerësimit mban procesverbal dhe shton pikët e kandidatit. Kandidati i cili ka qenë pjesëmarrës në portalin e mëparshëm dhe dëshiron të marrë pjesë në testim, do të renditet në listën përfundimtare me pikët e testimit të fundit. Kandidati i cili nuk paraqet dokumente shtesë pranë komisionit dhe nuk dëshiron të marrë pjesë në testimin e radhës, i mbarten pikët ekzistuese në renditjen e re deri në dy vjet.
8. Anëtarët e Komisionit të Vlerësimit firmosin deklaratën për pajtueshmërinë me ligjin për parandalimin e konfliktit të interesit, sipas shtojcës nr. 4.
9. Komisioni i Vlerësimit pasi administron dosjet e kandidatëve, brenda dhjetë ditë pune pas përfundimit të afatit të pranimit të aplikimeve, vlerëson dokumentacionin e paraqitur nga kandidatët dhe harton listën për çdo profil sipas çdo NJVKSH, renditja fillon me kandidatin me më shumë pikë dhe vijon në rend zbritës.
10. Komisioni i Vlerësimit, i dërgon DQOSHKSH-së listën e përgatitur si më sipër, për ta publikuar në Portalin “Infermierë për Shqipërinë”.
11. Në të njëjtën ditë që publikohet lista, Komisioni i Vlerësimit njofton me e-mail kandidatët që nuk janë kualifikuar për arsyen e moskualifikimit.

12. Kandidatët kanë të drejtën e ankimimit në adresën e portalit ose në adresën me të cilën marrin njoftimin, brenda tre ditëve nga data e shpalljes lidhur me vlerësimin e dosjes. Komisioni i vlerësimit brenda pesë ditë pune shqyrton ankesën, i kthen përgjigje ankimesit dhe reflekton ndryshimin e pikëve nëse ankesa ka qenë e drejtë.

3/2 TESTIMI I INFORMATIZUAR

1. Në fazën e dytë, “Testimi i informatizuar”, marrin pjesë kandidatët që kanë kaluar me sukses fazën e parë të vlerësimit me dosje. Në testim marrin pjesë dhe kandidatët që janë në listë pritje dhe dëshirojnë të përmirësojnë rezultatin e testimit të mëparshëm. Kandidatët që dëshirojnë të marrin pjesë në testim për të përmirësuar pikët e mëparshme, regjistrohen pranë drejtorisë rajonale përkatëse vetëm për testimin e informatizuar.

2. DQOSHKSH-ja përgatit listat e kandidatëve që do të marrin pjesë në testimin e informatizuar dhe ia dërgon në formë elektronike dhe me shkrim Qendrës së Shërbimeve Arsimore, në përputhje me rregullat e kësaj qendre.

3. Pyetjet e testit të vlerësimit hartohen në bazë të secilit profil të shpallur, nga pedagogët e Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike të Universitetit të Mjekësisë Tiranë. Kalendar i testimit publikohet në portalin “Infermier për Shqipërinë”.

4. Rezultatet e testimit të informatizuar i kalojnë DQOSHKSH-së, e cila bën renditjen e kandidatëve sipas pikëve totale, që nxirret nga shuma e pikëve të marra në vlerësimin e dosjes së aplikimit dhe pikëve të marra në testimin e informatizuar. Renditja fillon me kandidatin me më shumë pikë dhe vijon në rend zbritës. Lista publikohet në portalin “Infermierë për Shqipërinë”.

5. Në fund të procedurës së vlerësimit kandidati konsiderohet fitues nëse ka marrë mbi 40 pikë.

KREU 4

PROCEDURA E ZGJEDHJES SË VENDIT TË PUNËS DHE EMËRIMI I PROFESIONISTËVE TË SHKENCAVE MJEKËSORE TEKNIKE

1. NJVKSH-ja, si dhe qendrat spitalore identifikojnë vendet e lira të punës (parësor dhe spitalor) që krijohen dhe i raportojnë tek DROSHKSH-ja përkatëse brenda 2 (dy) ditëve nga data e krijimit të vakancës. Qendrat Spitalore Universitare raportojnë vendet e lira të punës pranë DROSHKSH Tiranë. DROSHKSH-të raportojnë vendet vakant të krijuara pranë DQOSHKSH-së, e cila i shpall ato në portal menjëherë.

2. Renditja përfundimtare e kandidatëve fitues administrohet nga DQOSHKSH-ja dhe shpallet në portalin “Infermier për Shqipërinë” dhe në faqen elektronike zyrtare të saj.

3. *Për vendet e lira të punës për çdo NJVKSH, kandidati njoftohet nga Komisioni i Vlerësimit të DROSHKSH-së përkatëse, në varësinë e së cilës është vendi vakant, përmes postës elektronike, mesazhit në celular dhe telefonatave në adresat të cilat kandidati i ka deklaruar gjatë aplikimit online dhe në dosje.*

4. Kandidati, i cili në renditjen e përgjithshme sipas NJVKSH-ve, është renditur me numrin më të madh të pikëve në profilin që ka aplikuar, ka të drejtën e zgjedhjes për vendet e lira të punës në institucionet shëndetësore të NJVKSH-së përkatëse dhe është i detyruar të konfirmojë në Komisioni i Vlerësimit brenda 24 orëve në adresën elektronike. Në rast se DROSHKSH-ja nuk merr konfirmim nga kandidati brenda këtij afati, atëherë vendi vakant i ofrohet kandidatit të radhës. Kandidati që nuk konfirmon pranimin e pozicionit të punës ose e refuzon atë, mbetet në listën e pritjes me të njëjtat pikë për një periudhë deri 2 (dy) vjet.

5. Kur dy kandidatë kanë pikë të barabarta, përzgjedhja e vendit të punës bëhet nga kandidati që i përket kategorisë së personave me aftësi të kufizuar nëse ka të tillë, nëse nuk ka PAK, vendi i punës i ofrohet kandidatit që ka pikët më të larta në testimin me shkrim.

6. Kandidati fitues që përzgjedh vendin e punës në institucionet në varësi të OSHKSH-së, merr aktin e emërimit nga DROSHKSH-ja dhe paraqitet pranë institucionit shëndetësor për të lidhur kontratën e punës, kandidati fitues që përzgjedh vendin e punës në Qendrat Spitalore Universitare, pajiset nga DROSHKSH-ja me vërtetimin për përzgjedhjen e bërë, si dhe fletë të printuar nga portali për rezultatin e tij. Titullari i institucionit lidh kontratë pune pa afat me punonjësin që zë një vend të lirë pune. Periudha e provës është tre muaj.

7. DROSHKSH-ja dokumenton procesin e zgjedhjes së vendeve të punës për çdo kandidat, si dhe raporton me postë elektronike dhe me shkresë zyrtare në DQOSHKSH, si dhe në MSHMS, brenda datës tre të çdo muaji për emërimet/refuzimet apo moskonfirmimet e kandidatëve.

8. Në rastin e krijimit të vendeve vakant të përkohshme (leje barrë lindje, pezullime etj.), pozicionet plotësohen nga kandidatët fitues në listë pritje, të cilët njoftohen sipas renditjes me pikë:

a) kandidati që punon si zëvendësues njoftohet sa herë krijohen vende të lira pune në NJVKSH përkatëse sipas radhës së listës së pritjes, për të zgjedhur vendet vakant të krijuara;

b) në rast se gjatë periudhës së punës si zëvendësues, në institucionin ku punon krijohet një vend i lirë pune, zëvendësuesi kalon me emërim definitiv, pavarësisht renditjes së tij me pikë;

c) në rast se në një institucion ka më shumë se një punonjës zëvendësues fitues i portalit, vendi definitiv i ofrohet atij që ka pikë më shumë.

d) në rast se deri në përfundim të periudhës së punës si zëvendësues nuk kalon në pozicion pune definitiv, kandidati kalon në listën e pritjes i renditur sipas pikëve të tij.

9. Në rast se do të ketë vende të lira pune, të cilat do të refuzohen nga të gjithë kandidatët fitues në listën e pritjes për atë njësi, këto pozicione mund të plotësohen përkohësisht, vetëm atëherë kur është e zauruar lista e fituesve sipas qarkut përkatës. Pozicioni i lirë mund të plotësohet nga kandidatë të licencuar në profilin përkatës deri në punësimin e kandidatit fitues nga portali. Në këto raste, NJVKSH-ja i drejtohet me kërkesë DROSHKSH-së, e cila pas një vlerësimi e përcjell kërkesën për miratim emërimi të përkohshëm pranë DQOSHKSH-së.

KREU 5 PROCEDURA E LËVIZJES PARALELE

1. Procedura e lëvizjes paralele bëhet për plotësimin e vendeve të lira vetëm brenda NJVKSH-së përkatëse.

2. Punonjësit e emëruar nëpërmjet portalit “Infermier për Shqipërinë” u lind e drejta për të kërkuar lëvizje paralele pasi të kenë mbushur 2 (dy) vite në të njëjtin vend pune.

3. Punonjësi i shkencave mjekësore teknike bën kërkesë për lëvizje paralele nga një qendër shëndetësore në një tjetër qendër shëndetësore ose spital dhe anasjelltas. NJVKSH-ja merr masa për mbulimin e shërbimit në qendrën nga e cila kërkon të largohet punonjësi dhe e dërgon kërkesën për miratimin e lëvizjes pranë DROSHKSH-së.

4. Lëvizjet paralele raportohen nga DROSHKSH-ja, brenda datës pesë të çdo muaji, pranë DQOSHKSH-së dhe Ministrisë.

KREU 6 MASA DISIPLINORE DHE LARGIMI NGA PUNA I TEKNIKËVE TË SHKENCAVE MJEKËSORE

1. Procedura disiplinore ndaj teknikut të shkencave mjekësore fillon nga drejtori/titullari i institucionit ku është i punësuar punonjësi.

2. Shkeljet disiplinore, si rregull përcaktohen në kontratën individuale të punës, si dhe në akte të tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi.

3. Procedura disiplinore duhet të garantojë të drejtën e punonjësit për t'u njoftuar lidhur me fillimin e procedimit, të drejtën për t'u dëgjuar, për të paraqitur prova, si dhe të drejtën për tu ankuar ndaj vendimit përfundimtar.

4. Tekniku i shkencave mjekësore mund të pezullohet nga puna për shkaqe të përcaktuara nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Gjatë kohës së pezullimit, punonjësit i ndërpriten marrëdhëniet financiare.

5. Largimi nga puna i teknikut të shkencave mjekësore bëhet nga drejtori/titullari i institucionit sipas akteve ligjore në fuqi dhe njoftohet NJVKSH/DROSHKSH përkatës.

KREU 7 DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

1. Për vitin 2019, të gjithë studentët e ekselencës të diplomuar duke filluar nga viti 2017 në profilet e shkencave mjekësore teknike, që aplikojnë në portalin “Infermier për Shqipërinë”, marrin një bonus 10 pikë shtesë në llogaritjen e pikëve për vlerësimin e dosjes. “Studentë të ekselencës”, janë studentët të cilët kanë përfunduar studime universitare në secilin prej cikleve të arsimit të lartë me mesatare 9.00–10 ose ekuivalent.

2. Të gjithë kandidatët që kanë marrë më parë pjesë në testimin “Infermiere për Shqipërinë” dhe nuk janë punësuar, do të dorëzojnë kërkesën për t'u regjistruar në listën e pritjes, pranë DROSHKSH-së përkatëse, duke përcaktuar deri në tre NJVKSH. Kandidatët që kanë aplikuar në më shumë se një qark do të përzgjedhin për t'u regjistruar në listën e pritjes, jo më shumë se tre NJVKSH gjithsej.

Kandidatët duhet të paraqesin kërkesën e tyre pranë DROSHKSH brenda një muaji nga miratimi i këtij udhëzimi. Deri në kryerjen e regjistrimit të kandidatëve si më sipër, do të veprohet sipas listave në rang qarku.

3. Dokumentacioni i krijuar gjatë zbatimit të procedurave të përcaktuara në këtë udhëzim ruhet pranë DROSHKSH për 10 (vite) vite dhe janë objekt i inspektimit të institucioneve të autorizuara nga ligji.

4. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse, Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor, si dhe institucionet shëndetësore.

5. Urdhri nr. 492, datë 13.11.2017 të ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale “Për miratimin e rregullores “Për organizimin e testimit për profesionet e shkencave mjekësore teknike për vendet vakante në institucionet shëndetësore publike në Republikën e Shqipërisë”, si dhe udhëzimin nr. 493, datë 13.11.2017 “Për procedurat e rekrutimit për profesionet e shkencave mjekësore në institucionet shëndetësore publike në RSH”, të ndryshuar, shfuqizohen.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I SHËNDETËSISË DHE
MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu

SHTOJCA 1

CURRICULUM VITAE

Emri, Mbiemri

Datëlindja: dd/mm/vvvv

Telefoni:

Adresa:

E-mail:

Arsimi:

Leja e ushtrimit të profesionit _____, (nr... data e lëshimit):

Kualifikim shkencor

Punësimi: Vitet dhe institucioni

Publikimet në fushën e shëndetësisë dhe fakti nëse është autor i parë ose bashkautor

Gjuhë të huaja: Niveli/ nota dhe institucioni që e ka lëshuar

SHTOJCA 2
DEKLARATË
PËR VERIFIKIMIN E VËRTETËSISË SË DOKUMENTEVE TË PARAQITURA NGA
KANDIDATI

Unë _____, kandidat në procesin e konkurrimit për profilin _____, të zhvilluar në _____, më datë _____, autorizoj _____ të verifikojë në çdo kohë vërtetësinë e dokumenteve të paraqitura nga ana ime.

AUTORIZUESI

SHTOJCA 3
KRITERET DHE SKEMA E VLERËSIMIT TË DOSJEVE TË KANDIDATËVE PËR
USHTRIMIN E PROFESIONEVE TË SHKENCAVE TEKNIKE MJEKËSORE

Nr.	Treguesit dhe kriteret	Pikët
1.	Përvoja në punë si profesionist i shkencave mjekësore teknike (një pikë për çdo vit pune, deri në 10 vite eksperiencë pune)	1-10 pikë
2	Studentët ekselent në fund të vlerësimit të dosjes dhjetë pikë shtesë (deri në 30 pikë gjithsej për vlerësimin e dosjes)	10 pikë
3.	Nota mesatare e studimeve të larta, vlerësimi bëhet sipas kësaj skeme: Nota mesatare (e thjeshtë) 5.00 - 5.50 = 1 pikë Nota mesatare (e thjeshtë) 5.51 - 6.00 = 2 pikë Nota mesatare (e thjeshtë) 6.01 - 6.50 = 3 pikë Nota mesatare (e thjeshtë) 6.51 - 7.00 = 4 pikë Nota mesatare (e thjeshtë) 7.01 - 7.50 = 5 pikë Nota mesatare (e thjeshtë) 7.51 - 8.00 = 6 pikë Nota mesatare (e thjeshtë) 8.01 - 8.50 = 7 pikë Nota mesatare (e thjeshtë) 8.51 - 9.00 = 8 pikë Nota mesatare (e thjeshtë) 9.01 - 9.50 = 9 pikë Nota mesatare (e thjeshtë) 9.51 - 10.00 = 10 pikë	1 -10 pikë

4.	Shkallët e kualifikimit në fushën e shëndetësisë: Studime të nivelit Mastër Profesional - 3 pikë Studime të nivelit Mastër Shkencor (të barasvlershëm) - 5 pikë	0- 5 pikë
5.	Dëshmi të njohjes së gjuhës/ve të huaja: a) Gjuhë e huaj e mbrojtur në IAL - të publike = 2 pikë b) Gjuhë e huaj e mbrojtur me testim ndërkombëtar nivel B 1 = 2 pikë c) Gjuhë e huaj e mbrojtur me testim ndërkombëtar nivel B 2 = 4 pikë Si gjuhë e huaj e mbrojtur llogaritet edhe rasti kur gjuha e huaj është e mbrojtur në kuadër të përfundimit të studimeve universitare të ciklit të dytë, sipas legjislacionit përkatës. Pavarësisht se kandidati mund të ketë disa gjuhë të huaja të mbrojtura, në këtë rubrikë nuk mund të llogariten më shumë se 5 pikë në vlerësimin e dosjes. Në rast se kandidati ka mbrojtur të njëjtën gjuhë të huaj në dy institucione të ndryshme, do të llogariten pikë vetëm për një dëshmi.	0 - 5 pikë

SHTOJCA 4
DEKLARATË PËR PAJTUESHMËRINË ME LIGJIN PËR PARANDALIMIN E
KONFLIKTIT TË INTERESIT

Deklaroj në përgjegjësinë time se në procesin e konkurimit për pozicionin infermier/teknik imazherie/ teknik fizioterapie_____ që do të zhvillohet në datë _____, nuk jam në konflikt interesi me asnjë prej kandidatave të paraqitura për konkurrim.

DEKLARUESI
DATA